**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije / Ministry of Finance*

*Thesari i Kosovës/Trezor Kosova/Treasury of Kosovo*

# Procedura për regjistrimin e Furnitorëve në SIMFK

Version i rishikuar, Mars 2018

# INDEKSI


1. Objektivi ........................................................ 3

2. Fushëveprimi ........................................................ 3

3. Baza Ligjore ........................................................ 3

4. Procedimi i regjistrimit të Furnitorëve në SIMFK ........................................................ 4

5. Dokumentet për regjistrimin e furnitorit ........................................................ 5

6. Kodet e furnitorëve ........................................................ 7

7. Mënyrat e kërkimit të Furnitorëve në SIMFK ........................................................ 10

8. Formularët ........................................................ 18

9. Të tjera ........................................................ 18


K

## 1. Objektivi

Synimi i këtij dokumenti është përshkrimi i procedurës mbi regjistrimin e furnitorit në SIMFK si dhe mënyra e kërkimit të të dhënave nga SIMFK.
Kërkesa për regjistrim të furnitorit iniciohet nga Organizata Buxhetore dhe dokumentacioni i nevojshëm dorëzohet në Thesar - Divizioni i Pagesave për regjistrimin e të dhënave në SIMFK.

## 2. Fushëveprimi

Kjo procedurë është për zbatim dhe në interes të:

- Organizatave Buxhetore,
- Thesarit në Ministrinë e Financave

## 3. Baza Ligjore

Kjo procedurë është në harmoni me Rregulloren Financiare 01/2013 për Shpenzimin e Parasë Publike, të lëshuar nga MF/Thesari.

## 4. Procedimi i regjistrimit të Furnitorëve në SIMFK

### 4.1 Skema e rrjedhës se procesit për regjistrim te furnitorit

| | Njësia përgjegjëse |
| --- | --- |
| Regjistrimi i Furnitorit në SIMFK iniciohet nga Organizata Buxhetore | Organizata |
| ↓ | |
| ZKF i Organizatës Buxhetore aprovon dokumentet e nevojshme për regjistrim të furnitorëve, verifikon në web faqen e ATK-së dhe ARBK-së dhe i dorëzon në Thesar/DP | Organizata |
| ↓ | |
| Thesari/DP- Zyrtari për regjistrim pranon dokumentet e nevojshme dhe e regjistron furnitorin në SIMFK | Divizioni i Pagesave - Thesar |

# 5. Dokumentet për regjistrimin e furnitorit

Asnjë furnitor nuk mund të regjistrohet në SIMFK pa plotësuar të dhënat minimale të nevojshme si fusha obligative. Një furnitor do te regjistrohet vetëm njëherë, dhe do te konsiderohet për çfarëdo pagese që duhet kryer nga cilado OB.

5.1 Në rastet kur kërkohet te hapet furnitor i ri, Zyrtari kryesor financiar (ZKF ) i organizatës buxhetore (OB) përveç verifikimit fizik të dokumentacionit të plotë ligjor, duhet të verifikojë të dhënat për furnitorin vendor në në web faqen e ATK-së (http://apps.atk-ks.org/bizpasiveapp/vatregist/index) dhe ARBK-së (htpp://arbk.rks-gov.net/), kurse për furnitorët e jashtëm për pjesën e të dhënave bankare duhet të kontrollojë me qellim orientues/identifikues të dhënat në web faqet:

- Verifikim IBAN https://www.ibancalculator.com/iban_validieren.html
- Verifikim SWIFT/BIC https://transferwise.com/swift-codes/bic-swift-code-checker

5.2 Te dhënat e verifikuara duhet të plotësohen (përshkruhen) në dokumentin " Formular për regjistrimin e furnitorit në SIMFK" i cili është i bashkangjitur ne këtë procedurë. Formulari me te dhënat e furnitorit duhet të nënshkruhet nga ZKF i organizatës buxhetore dhe dërgohet fizikisht përmes postës ose në mënyrë elektronike i skanuar qartë dhe lexueshëm, përmes e-mailit zyrtar tek personi (personat) e përcaktuar në Thesar/DP.

5.3 Informatat e nevojshme për regjistrim të furnitorit në SIMFK janë si në vijim:

➢ <u>Për persona fizik ose operator i jashtëm</u>

Formularit të plotësuar me të dhënat e Furnitorit duhet t'i bashkëngjiten një prej këtyre dokumenteve:

Kopja e faturës për pagese,

- Pro-faturës,
- Vendim ose
- Kontratë.

Te dhënat e përfituesit ne dokumentin e larte cekur duhet te përmbajë :

- Emri i plotë i përfituesit
- Adresa e përfituesit
- Banka e përfituesit
- Adresa e bankës së përfituesit
- IBAN kodi apo llogaria bankare (e validuar)
- SWIFT kodi (i validuar)
- Për person fizik edhe kopja e pasaportës

Të gjitha dokumentet e lartshënuara verifikohen konfirmohen fizikisht nga zyrtari i OB-se.



M

➢ **Për persona fizik vendorë**

Formularit të plotësuar me të dhënat e personit fizik duhet t`i bashkëngjiten këto dokumente:

- Kopje e dokumentit identifikues (letërnjoftim ose pasaportë)
- Kopje e kartelës bankare ose vërtetim nga banka

➢ **Operatorët vendorë**

Formularit të plotësuar me të dhënat e operatorëve vendor duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:

- Certifikata për regjistrimin e biznesit me informatat mbi biznesin
- Certifikata e numrit fiskal
- Kopja e kartelës bankare të operatorit ose vërtetim nga banka
- Kopja e dokumentit identifikues

5.4 Për pagesat e Vendimeve Gjyqësore dhe Përmbarimore për regjistrimin e furnitorit në SIMFK, formulari me të dhënat e nevojshme duhet të plotësohet nga Thesari/Administrata bazuar në dokumentacionin e pranuar nga autoriteti përkatës (Gjykatë apo zyre përmbarimi).

5.5 Për pagesa me kredit kartela për regjistrimin e furnitorit ne SIMFK, formulari plotësohet nga Thesari/Divizioni i Pagesave.

5.6 Për rimbursimet, regjistrimin e furnitorit ne SIMFK, formulari plotësohet nga vet OB.

5.7. Për vendimet e Qeverisë që ekzekutohen nga Thesari, për regjistrimin e furnitorit në SIMFK formulari me të dhënat e nevojshme duhet të plotësohet nga Thesari/Administrata bazuar në dokumentacionin e pranuar me shkresë nga Zyra e Kryeministrit së bashku me vendimin.

5.8 Furnitorët të cilët për tre vitet e fundit nuk kanë pas transaksione në SIMFK automatikisht bëhen joaktiv nga Thesari. Për riaktivizimin e tyre organizata buxhetore obligohet të inicioj procesin nga fillimi. Thesari/Divizioni i pagesave obligohet të riaktivizoj furnitorin nëse informatat janë identike, në të kundërtën do të regjistrohet si furnitor i ri.

5.9 Te gjithë furnitorët e regjistruar në SIMFK me numër unik 06XXXX01, VGJXXX, RBXXXXXX do të bëhen joaktiv në SIMFK. Organizatat buxhetore obligohen qe te dorëzojnë kërkesë për regjistrimi të këtyre furnitorëve në SIMFK

5.10 Thesari në baza të rregullta, apo kur ta konsideroj të nevojshme do të bashkëpunoj me Administratën Tatimore të Kosovës për të siguruar që cilësia e të dhënave të operatorëve është e duhur, për të siguruar edhe proces adekuat të 'urdhër-vjeljeve' dhe kujdes të duhur ndaj furnitorëve.

*Shënim: Organizatat buxhetore formuarin me dokumentet e kërkuara me larte i dorëzon ne Thesar/DP ne mënyrë fizike me se paku 3 dite para inicimit te pagesës.*

## 6. Kodet e furnitorëve

6.1 . Për regjistrimin e furnitorëve në SIMFK (përveç bizneseve të cilat regjistrohen me numër të biznesit), duhet të caktohet një numër rendor sipas së cilit bëhet identifikimi i llojit të furnitorit.

6.2 Caktimi i kodeve të furnitorëve bëhet si në vijim:

- Bizneset,– regjistrohen duke e përdorur kodin e biznesit të caktuar nga MTI dhe ATK.
- Partitë politike parlamentare, bashkësitë fetare ne SIMFK do te regjistrohen me te dhënat ne baze te dokumentit te regjistrimit ne institucionin përkatës.
- Individët – Kodi i furnitorëve për Individë fillon me 04 dhe vazhdon me numër rendor (p.sh. 04000001).
- Transferet ndërkombëtare – Kodi i furnitorëve për Transferet ndërkombëtare fillon me TN, vazhdon me numër rendor 300001 dhe përfundon me dy shifra të shtetit përkatës në të cilin bëhet transferi (p.sh. TN0300001TR, ku TR paraqet shtetin e Turqisë).
- OJQ-të (Organizatat Joqeveritare) – Kodi i furnitorëve për OJQ-të fillon me numrin e biznesit nga certifikata e regjistrimit të OJQ-së e cila fillon me 5XX p.sh. 5002220.
- Kredit Kartelat – Kodi i furnitorëve për përdoruesit e Kredit kartelave fillon me KK dhe vazhdon me 6 numrat e fundit të numrit të kredit kartelës së përdoruesit të saj (p.sh. KK594321)
- Depozitat e AKP – Kodi i furnitorëve për Depozitat e AKP-së (Agjencinë Kosovar të Pronës) fillon me AKP dhe vazhdon me numër rendor (p.sh. AKP00001).
- Taksat Komunale – Kodi i furnitorëve për Taksat Komunale fillon me 07 dhe vazhdon me numër rendor (p.sh. 07000001).
- Ambasadat – Kodi i furnitorëve për Ambasada fillon me AMB dhe vazhdon me numër të kodit të llogarisë së regjistruar në SIMFK (p.sh. AMB249).
- Konsullatat – Kodi i furnitorëve për Konsullatat fillon me KON dhe vazhdon me numër të kodit të llogarisë së regjistruar në SIMFK (p.sh. KON245).
- Pagesat Direkte të Granteve – Kodi i furnitorit për Pagesat Direkte të Granteve fillon me PDG (pagesë direkt nga Grantet) dhe vazhdon me numër rendor 000001, (p.sh PDG000001).
- Pagesat Direkte nga Borxhet - Kodi i furnitorit për Pagesat Direkte të Borxheve fillon me PDB (pagesë direkt nga Borxhet) dhe vazhdon me numër rendor 000001, (p.sh PDB000001).
- Furnitorët për udhëtime zyrtare ne SIMFK, fillon me A201-400XXX , A (avancë), 201(kodi i organizatës buxhetore, 400XXX (numri rendor i përcaktuar nga DP).
- Pagesat me lista – Kodi i furnitorit është 20 dhe kërkesa për ekzekutimin e pagesave me këtë shifër të furnitorit duhet ti drejtohet Thesar/DP.

Shembull i formularit të plotësuar për regjistrim të furnitorit:

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave*
*Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance*
*Thesari - Trezor - Treasury*

| FORMULAR PËR REGJISTRIM TË FURNITORIT | | | |
|---|---|---|---|
| **Statusi i furnitorit** | | | |
| Biznes | | Individ | |
| I regjistruar në Kosovë | ☐ | Kosovar | ☐ |
| Ndërkombëtar | ☐ | Ndërkombëtar | ☐ |
| Organizatë joqeveritare | ☐ | | ☐ |

**Të dhënat e furnitorit**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Nr. i regjistrimit të biznesit / Nr. i regjistruar në Thesari | | | |
| Numri fiskal | | | |
| Emri i biznesit / individit | | | |
| Emri i llogarisë bankare | | | |
| Pronari i biznesit | | | |
| Adresa (Rruga/Qyteti/Shteti) | | | |
| Telefoni (1) | | Telefoni (2) | |
| Nr i Faxit | | | |
| Email Adresa | | | |
| ID e pronarit / individit (numri dhe lloji) | | Lloji: | |
| Emri i bankës | | | |
| Numri i llogarisë bankare | | | |

**Vetëm pagesat ndërkombëtare:**

| | |
|---|---|
| IBAN kodi | |
| SWIFT kodi | |
| Banka ndërmjetësuese | |
| SWIFT/IBAN kodi i bankës ndërmjetësuese | |

**Kërkesa për regjistrim**

| | |
|---|---|
| Organizata buxhetore: | Data: |
| Emri mbiemri: | Nënshkrimi: |
| Titulli: Zyrtari kryesor financiar | |

| | |
|---|---|
| **Regjistrimi në SIMFK** | Data e regjistrimit: |
| Regjistruar nga: | |

Shembull i formularit të plotësuar për procedim të transfereve ndërkombëtare:

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave*
*Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance*
*Departamenti i Thesarit - Departament Trezora - Treasury Department*

| FORMULAR PËR REGJISTRIM TË FURNITORIT | | | |
|---|---|---|---|
| **Statusi i furnitorit** | | | |
| Biznes | | Individ | |
| I regjistruar në Kosovë | X | Kosovar | |
| Ndërkombetar | | Ndërkombëtar | |
| Organizatë joqeveritare | | | |

**Të dhënat e furnitorit**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Nr. i regjistrimit të biznesit / Nr. i regjistruar në Thesari | T N 3 0 0 4 0 0 FR | | |
| Numri fiskal | | | |
| Emri i biznesit / individit | WELCOME EUROPE | | |
| Emri i llogarisë bankare | WELCOME EUROPE | | |
| Pronari i biznesit | | | |
| Adresa (Rruga/Qyteti/Shteti) | 38, RUE LEO[illegible] | | |
| | PARI[illegible] | | |
| Telefoni (1) | +33 1[illegible] 00 01 | Telefoni (2) | |
| Nr i Faxit | +[illegible]3 142 00 00 04 | | |
| Email Adresa | | | |
| ID e pronarit / individit (Nu[illegible]) | | Lloji: | |
| Emri i bankës | Societe General Paris stock Exchange Enterprises | | |
| Numri i llogarisë bankare | | | |

**Vetëm pagesat ndërkombëtare:**

| | |
|---|---|
| IBAN kodi | FR - 7630003/03340/000123/00025662314/01 |
| SWIFT kodi | S O G F R P P |
| Banka ndërmjetësuese | |
| SWIFT/IBAN kodi i Bankës ndermjetësuese | |

**Kërkesa për regjistrim**

| | | |
|---|---|---|
| Organizata buxhetore: Ministria e shëndetësisë | | |
| Emri: Emri Mbiemri | | Data: 21 04 2012 |
| Titulli: Zyrtari kryesor financiar | | Nënshkrimi: [signature] |

**Regjistrimi në SIMFK**

| | |
|---|---|
| Regjistruar nga: | Data e regjistrimit : |

# 7. Mënyrat e kërkimit të Furnitorëve në SIMFK

Furnitorët në SIMFK mund të kërkohen në dritaret si në vijim:

- Moduli i Buxheti dhe Përvetësimet/Obligimet
- Moduli i Blerjes/Urdhër blerja
- Moduli i Shpenzimeve/ Kuponët e Shpenzimit

Moduli i Buxhetit dhe Përvetësimet/Obligimet



## Moduli i Blerjeve/ Urdhër blerja



## Moduli i Shpenzimeve/ Kuponët e Shpenzimit




Në të gjitha rastet metoda e kërkimit është e njëjtë. Në rastin tonë furnitorin do ta gjejmë nga dritarja e Kuponit të Shpenzimeve.

Duke klikuar në butonin 




Do të hapet dritarja në vijim




Në fushën "Kodi" ose fushën "Emri" mund të bëhet kërkimi.




Në fushën "Kodi" shënohet kodi nëse e dini, dhe klikojmë në butonin 




Në fushën "Emri" mund të shënohen shkronjat e para, vendoset shenja * dhe klikojmë në butonin shtypet  , si në dritaren më lartë:

Pasi ta shtypni butonin  "Gjeje", paraqitet tabela në vijim me të gjithë shitësit (furnitorët) që fillojnë me "KU...". .




Klikojmë tek kodi i përfituesit për të përzgjedhur.

Keni raste kur  furnitori shpesh herë ka më shumë se një llogari p.sh:




Kur është regjistruar furnitori për çdo llogari të re bankare është hapur një furnitor i ri me kodin e njëjtë të furnitorit  duke e dalluar atë nga llogaria tjetër me një shkronjë (A,B etj).

Klikojmë tek kodi i përfituesit për të përzgjedhur furnitorin ku do të hapet dritarja e përfituesit ku mund të verifikojmë llogarinë bankare.

Për individët dhe kompanitë vendore verifikohen të dhënat si në shembullin e mëposhtëm:



Furnitorët për individët dhe kompanitë e huaja

Regjistrimi i Nr. të furnitorëve për individët dhe kompanitë e huaja të cilat procedohen përmes transfereve ndërkombëtare do të fillojë me TN dhe do të dallohen individët dhe kompanitë si në vijim:

Nr. i furnitorëve për individë - TN500001TR: TN - transfer ndërkombëtar; 5 – individ; 00001 – nr. rendor; TR – Turqi (Shteti)).

Nr. i furnitorëve për kompani të huaja - TN300059AU: TN (transfer ndërkombëtar; 3 – kompani; 30059– nr. rendor; dhe AU – Australia(Shteti)).




Për verifikimin e të dhënave për individët dhe kompanitë e huaja të cilat procedohen përmes transfereve ndërkombëtare duhet klikuar në butonin  afër llogarisë bankare, pas së cilës paraqitet dritarja në vijim:

**Llogaria Bankare**

| | |
|---|---|
| * Institucioni Financiar | INTVND |
| * Degë | TN300059AU |
| * Valutë | EURO |
| * Numri i Llogarisë | 06214010250357 |
| IBAN | 06214010250357 |
| Kodi Kombëtare për Transfer | |
| * Emri i Llogarisë Bankare | COMMONWEALTH BANK AUSTRA.SYDNE |
| Lloji i Llogarisë | 443 VICTORIA AVENUE |
| Rrjedha e Informatës | CHATSWOOD |
| Komentet | AUSTRALIA |
| Intermediary Bank BIC | |

<u>Shënim</u>: Nëse në rastin tuaj në faturë vëreni se numri i llogarisë nuk korrespondon me asnjërën nga llogaritë e regjistruara në SIMFK, në atë rast duhet të bëni kërkesë në Thesar te dorëzoni kërkesën dhe dëshminë konfirmimin nga banka për regjistrimin e llogarisë bankare te furnitorit ne SIMFK.

## 8. Formularët

Formulari i zbrazët për regjistrim të furnitorit mund të gjendet në webfaqen e MF:

http://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,55

## 9. Të tjera

9.1. Kjo procedure aprovohet me vendim të datës 30.03.2018 dhe hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit, duke shfuqizuar Procedurën e deritanishme.

9.2. Rishikimi i kësaj procedure do te behet ne baza periodike apo edhe sipas nevojës.

Aprovuar nga:

Datë: 30.03.2018

Ahmet Ismaili
*Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit*

REPUBLIKA E KOSOVËS • MINISTRIA E FINANCAVE • THESARI
REPUBLIKA KOSOVA • MINISTARSTVO FINANSIJA • TREZOR
REPUBLIC OF KOSOVO • MINISTRY OF FINANCE • TREASURY
PRISHTINË